



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 18.06.2024,
me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinoviqi, Elmira Nikçi - Rexha, Oktay Kurteshi, Trieria Kasumi - Berisha, Faton Marolli, Kimeta Shok, Adnan Ajeti.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Klaudia Mula, zyrtare për komunitete në ZKKK, Jehona Lushaku - Sadriu, u.d. e drejtores së Drejtorisë së Arsimit, Qefsere Berisha - Veseli, zyrtare nga ZKKK, Liridona Preniqi, zyrtare nga Drejtoria e Arsimit, Seniha Bajraktari, zyrtare nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Eroll Raskova, udhëheqës i sektorit të Financave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit znj. Mirsada Behluli, me këtë

R E N D D I T E :

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes sëkaluar të KK-së;
- Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit, znj. Jehona Lushaku - Sadriu:
 - Të na informojë se si ka shkuar procesi mësimor në vitin shkollor 2023/2024,
 - A ka pasur probleme me tekste shkollore për nxënësit e komuniteteve joshumicë? Aka pasur braktisje të shkollës në pjesët ku jetojnë komunitetet joshumicë, mungesë të mësimdhënësve etj.?
- Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Bekim Brestovci, (informim rreth sfidave në regjione ku jetojnë komunitetet joshumicë, koordinimi i përbashkët për aktivitete gjatë vitit 2024);
- Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Financave, znj. Valbona Makolli (të na informojë lidhur me ndarjen e buxhetit për vitin 2024);
- Formimi i Komisionit përpilimin e raportit gjashtëmujor të punës së Komitetit për Komunitete;
- Formimi i Komisionit për vizitë Zyrës për çështje të komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrat;

Faqe 1 nga 8

7. Raporti i ZKKK-së për muajin maj 2024;
8. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
9. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit, znj. Jehona Lushaku - Sadriu:

- (a) Të na informojë se si ka shkuar procesi mësimor në vitin shkollor 2023/2024,
- b) A ka pasur probleme me tekste shkollore për nxënësit e komuniteteve joshumicë?
A ka pasur braktisje të shkollës në pjesët ku jetojnë komunitetet joshumicë, mungesë të mësimdhënësve etj.?

Mirsada Behluli lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia dha drejtores së Drejtorisë së Arsimit, që të informojë se si ka shkuar procesi mësimor në vitin shkollor 2023/2024, dhe a ka pasur probleme me tekste shkollore për nxënësit e komuniteteve joshumicë, a ka pasur braktisje të shkollës në pjesët ku jetojnë komunitetet joshumicë, mungesë të mësimdhënësve etj.

Jehona Lushaku - Sadriu, theksoi se është shumë e gjëzuar që raportin të cilin do ta paraqesë është shumë pozitiv. Kjo është gjë e mirë edhe për komunitetet, si dhe për ne që menaxhojmë këtë sektor. Procesi i arsimit në përgjithësi gjatë këtij viti shkollor, po përfundon me sukses. Në të gjitha shkollat është zhvilluar procesi mësimor i rregullt, përgjithësisht kemi pasur statistika të ulëta të braktisjes së shkollave, kurse sa i përket komuniteteve, në veçanti, kemi pasur braktisje vetëm nga një nxënëse i shkollës "Emin Duraku", një nxënëse e klasës së VIII. Furnizimin me tekste shkollore e ka bërë Ministria, direkt tek prindërit, mandej prindërit janë obliguar që t'i blejnë librat vetë, nga katalogu i librave që ka qenë i certifikuar prej Ministrisë së Arsimit. Kjo ka vlejtur për të gjitha grupet e komuniteteve, por ka vlejtur, për të gjithë nxënësit e komunitetit shqiptarë. Ndërsa sa i përket statistikave të sakta për blerjen e teksteve, tha se statistikat e sakta se a i kanë blerë prindërit librat, këtë nuk e dimë, por gjatë vizitave që i kami pasur edhe në shkolla ku ka edhe komunitete, është thënë se të gjithë nxënësit i kanë librat. Kjo është sa i përket përgjigjes së parë për tekstet. Unë kam zhvilluar takim me komunitetin turk në shkollën "Elena Gjika" dhe me klasën që është boshnjak-kroat, që është në shkollën "Naim Frashëri", të gjitha këto klase janë të mbuluara me mësimdhënës, por ka disa mësimdhënës që i mbulojnë disa grupe nxënës, dhe kjo vjen për shkak të mungesës së stafit të kualifikuar për secilën lëndë, por ankesa në kuptimin e cilësisë nuk ka. Kjo është e përgjithshme. Unë jam e gatshme, së bashku me Liridonën që është këtu, e cila është marrë specifisht me komunitetet, çfarëdo pyetje që keni, mundem me ju përgjigjur.

Faqë 2 nga 8

Oktay Kurtesh shprehu shqetësimin lidhur me përkthimin e librave që janë nëpër shkolla, e të cilat nuk janë në nivelin e duhur. Nëse nuk gaboj, janë me Ministri, edhe në shkollën "Sami Frashëri" nuk ka, nuk e di se a e keni vizituar, me diktum shkon tash e 25 vjet.

Jehona Lushaku - Sadriu u shpreh se sa i përket furnizimit me tekste, është specifikisht i Ministrisë, faktikisht ne nuk kemi dhe nuk shkon përmes nesh, por po ju njoffojë që shkollat profesionale në Prishtinë, nuk kanë tekste bazike. Vetëm dua t'ju tregoj se ka shumë mungesa në shumë lëndë nëpër shkolla për tekste, por këtë punë mundem me e ngritur edhe në Ministri.

Liridona Preniqi tha se sa i përket gabimeve në përkthim, ju si stafe apo kushdo që punon nëpër shkolla, duhet me i paraqitë këto gabime gjuhësore, apo këto gabime në përkthim të teksteve shkollore dhe MASHT do të reagojë.

Kimeta Shok tha se pasi që tani vjen regjistrimi në fakultet, sa është numri i siguruar për komunitetit jo shumicë, edhe pse aq shumë vonohet përkthimi në gjuhën boshnjake, dhe librat janë shumë të vonuar.

Jehona Lushaku - Sadriu, duke iu përgjigjur znj. Shok tha se tash unë jam profesroreshë edhe në Universitetin e Prishtinës, dhe e di se Universiteti i Prishtinës ka kuota ka për secilin drejtim, më duket se 5%, është për komunitete, por zakonisht pranimi i komuniteteve në Universitet bëhet automatikisht, ndonjëherë, më shumë ndonjëherë më pak, ndonjëherë më shumë se 5%, ndonjëherë më pak, krejt që regjistrohen si komunitete pranohen pa konkurrencë, besoj se kjo nuk është problem për universitet.

Kimeta Shok shtroi pyetje se a duhet të sjellim vërtetimin se jemi pakicë kur të regjistrohen fëmijët në shkolla dhe fakultete, pasi që vitin e kaluar iu është kërkuar vërtetimi për të dëshmuar se çfarë nacionaliteti u përkasin.

Jehona Lushaku - Sadriu: lidhur me shqetësimin që ka të bëjë me marrjen e vërtetimeve si dëshmi se të cilit komunitete i përkasin, tha se ajo çka mundem me e bërë unë, është me i shkruar Universitetit dhe me u thënë se çdo dokument që lëshohet nga Qendra e Regjistrimit, është valid.

Elmira Nikçi - Rexha propozoi që me e nxjerrë një rekomandim në fund, që me biseduar me Drejtorin e Administratës, që ata me ua dërgua një njoftim, në Bashkësitë Lokale, për të lëshuar vërtetimin, duke e shënuar nacionalitetin. Bashkësitë Lokale, e kanë obligim me lëshua këtë vërtetim, ne bisedojmë me Drejtorin e Administratës, që t'ju dërgojnë një njoftim.

Klaudia Gega - Mula tha se, me sa e di unë, janë duke e punuar një rregullore të re, e di se ka me qenë edhe kjo pjesë për lëshimin e vërtetimeve, kam biseduar edhe me shefen e Bashkësisë Lokale, Arlindën, e di se janë në procedurë të rregullores, për zgjidhjen e këtij problemi.

Jehona Lushaku Sadriu, duke u ndërlidhur në diskutim, tha se siç tha Ema, është mirë ju si komunitet me dalë me një konkluzion, prej takimit të sotëm për Drejtorinë Administratës.

Triera Kasumi - Berisha, duke iu drejtar drejtores së Arsimit znj. Lushaku Sadriu, tha kam disa pyetje. Si rezultat i vitit të kaluar që kemi qenë në komision, nëpër shkolla, në paralele të komuniteteve, kemi pasur disa raportime, me të cilat një prej pyetjeve prej këtyre raportimeve, ka qenë, a ka raste të bullizimit nëpër shkolla, dhe në secilën shkollë përgjigja ka qenë se nuk ka asnë rast. Unë e kam njoftuar edhe drejtoreshën më herët që ka qenë dhe më është dukur shumë e çuditshme, raportimi jo real, se më duket krejt jo reale nëse thuhet se në shkollat fillore nuk ka bullizim, sidomos jo komunitetet pakicë. Prandaj, po më intereson me ditë se a ka ndonjë hap që ka ndërmarrë drejtoria në kuadër të bullizimit, çoftë ndonjë fushatë që ka ardhur nga qeverisja qendrore.

Jehona Lushaku - Sadriu: duke iu përgjigjur znj. Kasumi Berisha, tha se kjo tek vërtetësia e pyetësorëve, shpeshherë nuk na dalin real, sepse edhe fëmijët, nuk e di se si, se ka të bëjë me kulturën tonë se si përgjigjemi në pyetje, se ne kemi çështje të mëdha jo me bullizimin, sepse bullizimi është çështje serioze nëpër shkolla tona.

Ajo mes tjerash tha se ne jemi duke bërë kampanja, së bashku me policinë dhe prokurorinë, që janë kampanja që kanë të bëjnë edhe me bullizimin, drogat, parandalimet, është një program i gjerë për mënyrën e sjelljes nëpër shkollë. Jemi duke punuar si DKA-a, për një kod të sjelljes brenda shkollave, këshillat e shkollave i kanë nxjerrë, ku disa shkolla kanë kode dhe aty duhet të punohet rrëth parandalimit dhe vetë me i inkuadruar edhe prindërit kundër bullizimit, për promovimin e një kulture kundër bullizimit, këtë po duam ta bëjmë nga shtatori, një lloje tjeter të komunikimit brenda shkollës me prind, nxënës, arsimtarë dhe psikologë.

Liridona Preniqi bëri të ditur se psikologët e shkollave kanë përgatitur dhe kanë mbajtur fushata vetëdijësuese, në shkollat ku ata punojnë, edhe DKA-ja ka mbajtur disa takime me psikologë të shkollave, një nga temat kryesore ka qenë edhe tema e bullizimit. Tash rastet janë individuale nëpër shkolla, mirëpo psikologët kam informata që në vazhdimësi kanë mbajtur edhe takime individuale edhe në rastet ku ka pasur bullizëm, por edhe ligjëratë, në kuadër të krejt shkollës.

Pika e tretë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z. Bekim Brestovci (Informim rrëth sfidave në regjione ku jetojnë komunitetet joshumicë, koordinimi i përbashkët për aktivitete gjatë vitit 2024).

Mirsada Behluli lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia dha zyrtares së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, znj. Seniha Bajraktari.

Seniha Bajraktari lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se më vjen mirë që gjerat janë duke shkuar në përmirësim e sipër, pasi që viti 2023 ka qenë viti më i keq që ka mundur me qenë me gjendjen e mbeturinave në kryeqytetin e Prishtinës dhe për të gjitha komunitetet dhe në çdo vend. Deponitë e egra, jemi munduar që në maksimum me i larguar, por vetëdija e qytetarëve nuk është në nivel, ato kanë qenë deponi që janë largu dhe menjëherë pas një kohe, janë krijuar prapë, kjo ka qenë edhe për shkak të gjendjes së rëndë që ka pasur ndërmarrja publike "Pastrimi", në mungesë të makinerisë, në mungesë të stafit të punëtorëve, d.m.th. kjo gjendje ka ndërrua, për mos me thënë

80%, por 60%, po. Janë ndërruar plotësisht kontejnerët, kanë ardhur dhe janë shpërndarë nëpër pika, aty ku kanë munguar janë shtuar.

Nenad Miladinoviç, duke u ndërlidhur në diskutim, tha se kur është në pyetje Drejtoria e Shërbime Publike, i kam tri probleme për t'i shtruar. Problemi i parë është deponia në Bërnicë të ulët. Ky problem nuk është nga dje, as sot, por ky problem është në 10 vitet e fundit, por prej periudhës para 2-3 vite kemi pasur pastrimin e rregullt, duke e mbajtur disi në kontroll këtë deponi, pastrimi në fillim është bërë në bashkëpunim me Inspeksionin dhe policinë dhe e kemi parandaluar hedhjen e mbeturinave, por këto vitet e fundit kjo deponi nuk është pastruar. Po më vjen mirë se kemi qenë dhe para 1 muaji, ku ka qenë prezent edhe KFORI, OSCE, UNMIKU, komisioni nga Komuna e Prishtinës, dhe të gjithë e kanë parë, se si qëndron e vërteta, apeloj tek ju që kjo deponi të pastrohet përsëri dhe disi të vendoset nën kontroll me ndihmën e policisë, që të shënohet se është e ndaluar hedhja e mbeturinave edhe është vetëdija e njerëzve aty që jetojnë. Për fat të keq, jemi shumica, ky ishte problemi i parë. Problemi i dytë, po ashtu është problem i madh, ai është shtrati i lumbit në Bërrnicë, shpresojmë që këtë problem vitin e ardhshëm ta rregullojmë, në bazë të vizitës në Bërrnicën e ulët, drejtori Krenari na ka thënë se do të hyjë në buxhet për vitin 2025, dhe se kjo do të rregullohet vitin tjetër.

Adnan Ajeti shtroi problemin lidhur me mbeturinat, ku thotë se ne e kemi një problem me mbeturinat këtu tek Parku i qytetit, ka mbeturina qe 3 vjet, pasi që aty është një shtëpi e vjetër e cila është e mbushur me mbeturina ku neve na bën problem.

Seniha Bajrakati lidhur me diskutimin e z. Ajeti, tha se shtëpia është private, njerëzit e kanë përdorur dhe kanë hedhur mbeturina, mirëpo problemi është se ne në shtëpi private nuk kemi të drejtë me hy, jemi munduar me vendim të kryetarit me bërë diçka në pronat private, në momentin se ndërhyjmë në pronat private, ne kemi problem me qytetarë, nuk është pse ne nuk po ndërhyjmë, nuk kemi problem me prona, vetëm brenda ditës me na informuar, ne e dërgojmë dikë me larguar mirëpo në pronë private, nuk kemi bazë ligjore me shkuar dhe me ndërhyrë se mua pikërisht më është kërkua çka me bërë ne në pronat private, mirëpo ligji i mbeturinave nuk ta lejon ty me hy në pronë private dhe me e menaxhuar. Në një pronë këtu në lagjen "Tophane" ju e dini, që kanë qenë disa shtëpi, jemi munduar me i larguar, janë larguar ato mbeturina, por sot e atë ditë janë me probleme, me gjykata, se pse është hyrë atje në atë pronë.

Ajo mes tjerash, tha se është vetëm një mundësi që me shkuar inspeksioni me ju lënë një vërejtje, nëse pronari nuk është, nuk e lexon vërejtjen, ne kot e kemi, me ligj e paralajmëron palën.

Oktay Kurtesh parastroi një kërkesë për ndriçim, në rr. "Agim Ramadani" dhe "Bajram Kelmendi" pastaj semaforët nuk janë të koordinuar, kur të hapet semafori për vetura, në po të njëjtën kohë hapet edhe për këmbësorë, që d.m.th. tri parë semaforë janë të hapur në të njëjtën kohë!

Seniha Bajraktari- lidhur me semaforët, tha se koordinimi i semaforëve duhet të bëhet, pasi që trupat ndriçues janë apo janë në defekt, janë prishur. Aty ku kemi kontratë shumë shpejt rregullohen, pasi që janë vetëm dritat, ose nuk ka kontratë dhe ka mbetur ose nuk e ka lajmëruar dikush, dritat tek Bajram Kelmendi, nëse është kontrata dritat brenda ditës rregullohen.

Nenad Miladinovići duke u ndërlidhur në diskutim, tha se kur po flasim për ndriçim, edhe unë e kam një kërkesë për Bërrnicën e Ulët, ekziston rruga ku vetëm një automjet mundet të kalojë, aty kemi çdo herë probleme me veturat që kalojnë, se kush ka përparësi, a mund të caktojmë që ajo rrugë të jetë vetëm një drejtim, rr. "Sveta Troica", aty është problem se vetëm një automjet mundet me kaluar, personat po përlahanë në mes vete, dhe kishte me qenë mirë që kjo rrugë të ketë vetëm një drejtim dhe jo dy, siç i ka tash.

Seniha Bajraktari u shpreh se nëse nuk ju vjen keq, unë mundem me iu dhënë si këshillë se qysh shkojnë procedurat. Të mblidhen nënshkrimet e qytetarëve të asaj ane dhe të vijnë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që të paraqesin kërkesën e tyre, si propozim, që ajo rrugë të bëhet rrugë me një drejtim, nëse ajo rrugë i plotëson kushtet, që të kalojë në rrugë një drejtimëshe, që qytetarët të kenë rrugë alternative, besojë se nuk do të ketë asnje problem.

Pika e katërt

Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Financave, znj. **Valbona Makolli** (Të informojë lidhur me ndarjen e buxhetit për vitin 2024).

Erroll Raskova duke iu drejtar të pranishmëve, tha se unë krejt çka mundem me ju informuar është se prej disa vitesh nga Ministria e Financave, na është deleguar buxheti për zyrën për komunitete, d.m.th. ne kemi për 5 punëtor, i kemi 50,000.00 euro, për 1 vit rrogat e tyre. Kemi për mallra dhe shërbime për Zyrën për komunitete komunale, 120,000.00 euro në vit, kemi edhe pagesa të ndryshme komunale, varësisht prej tyre edhe këto janë 18,000.00 euro, d.m.th. ky buxhet nuk është i këtij viti, por që 6 apo 7 vite është çdo herë i njëjtë. Unë po flas vetëm për shpenzime operative, sepse ato kapitalet janë të ndërlidhura me drejtoritë e ndryshme. Së pari duhet t'i marrim informacionet prej mjeteve, Sektori i arsimit mundet me i shfrytëzua përmes zyrës së komuniteteve me shfrytëzua buxhetin, sepse ky është i ndarë për komunitete, Zyra komunale për komunitete, e cila i ka 120,000.00 euro në vit, normal që nëse është problemi për komunitete, këto janë mallra dhe shërbime, përndryshe shpenzohen në fund se për çka duhen, mirëpo kishte me qenë mirë që Zyra për komunitete nëse ka nevojë pse mos me i shfrytëzuar.

Klaudia Gega - Mula tha se ne sapo e kemi parë kërkesën, shihet se është dashur me një kod buxhetor të një drejtorie, pra a kemi mundësi ne që të shfrytëzojmë këtë pjesë tanë kur e kuptuam.

Erroll Raskova duke u ndërlidhur me diskutimin, tha se gjërat janë të ndara, mirëpo këto janë të ndara për Zyrën e komuniteteve. Unë po e them se nëse nuk shfrytëzohet për atë, shfrytëzohet përdiku tjetër.

Elmira Nikçi - Rexha tha se për hir të korrektësisë për të gjithë shtroi pyetje, pasi që ndoshta edhe shumica nuk e kuption, por çka d.m.th kategoria "mallra dhe shërbime", çka mundet me u pagua brenda asaj kategorie.

Erroll Raskova: tha se brenda kësaj kategorie munden me u paguar, blerjet e ndryshme të mallrave, blerjet të ndryshme të shërbimeve, por nuk e di se sa kuptuat me këtë, por këto mallrat dhe shërbimet mundesh një kategori, jo sipas kategorisë së kapitaleve që i ka të kategorizuara çdo projekt, por ky

Faqe 6 nga 8

është thes i mallrave dhe shërbimeve. D.m.th. çdo blerje dhe çdo shërbim, me përjashtim të subvencionimit, por ky është çdo aktivitet që ka të bëjë me blerje dhe shërbim.
Ai në vazhdim tha se me këtë mundet me u mbulua arsimi, përmes Zyrës së komuniteteve.

Kimeta Shok tha se ne kemi kërkuar transport për fëmijë, na kanë thënë se nuk ka buxhet, ndërsa ne nuk kemi qenë në dijeni për këtë që na njoftuat ju.

Erroll Raskova tha se unë vetëm ju tregova për buxhetin e ndarë për komunitete, nëse keni ndonjë pyetje tjeter, unë jam këtu për përgjigje, programet buxhetore janë këto.

Nenad Miladinoviqi u shpreh se ju keni thënë që buxheti është rritur për vitin 2024, ndërsa sa i përket shumës së ndarë për komunitete është e njëjtë.
A ka rritje buxheti për investimet kapitale?

Erroll Raskova duke iu drejtuar të pranishmëve, tha se sipas cirkularit, me vite të tëra ka qenë e njëja, ndërsa sa i përket investimeve kapitale, p.sh. aty ka të futura edhe rrugë edhe gjëra të ndryshme të fshatrave, pavarësisht komuniteteve, ju duhet me gjetur vetën përmes programeve të ndryshme, aty e kemi programin e menaxhimit të kontratave, përmes Krenarit, kemi edhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për forma të ndryshme të aktiviteteve, që janë rryma dhe sendeve, ka edhe Drejtoria e Parqeve, e cila ka gjëra të ndryshme.

Klaudia Gega - Mula, duke u ndërlidhur me pyetjen e Nenadit, tha se ne e kemi një buxhet shumë solid për investimet kapitale, por ne nuk jemi ndalur me këtë buxhet, gjithmonë drejtoria e investimeve kapitale ka shtuar mjete nga buxheti i vet, nuk është e thënë shpenzohen 100,000.00 euro për investime kapitale, por është shpenzuar sipas nevojës së përfundimit të projektit.

Erroll Raskova bëri të ditur se përparrë kanë qenë të detalizuara projektet kapitale, si projekte të Zyrës së komuniteteve, mirëpo nga viti 2023 ne kemi pasur problem ose e ndërroni përviktimin, ose i vendosin në rezerva. Kështu që ato janë të detajuara, nëpër programe të ndryshme. Unë sa e di, ka edhe për Bërnicë, por ju duhet të gjeni mënyrën e kërkesën, që të kontaktoni direkt drejtoritë për të parë se çfarë mund të bëhet.

Pika e pestë

Formimi i Komisionit përpilimin e raportit gjashtëmuajor të punës së Komitetit për Komunitete.

Mirsada Behluli, për Komisionin përpilimin e raportit gjashtëmuajor të punës së Komitetit për Komunitete, propozoi këta anëtarë: Mirsada Behluli, Ermira Nikçi - Rexha dhe Oktay Kurtesh. Njëzëri u miratua formimi i Komisionit, me përbërjen e lartëcekur.

Pika e gjashtë

Formimi i Komisionit përvizitë Zyrës përsështje të komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit.
Kjo pikë e rendit të ditës mbetet të diskutohet në njërin prej takimeve të ardhshme.

Faqe 7 nga 8

Pika e shtatë

Klaudia Gega Mula, sa i përket raportit mujor të Zyrës për komunitete, besojë se e keni lexuar me vëmendje, janë implementuar disa aktivitete të parapara, me planin e punës të këtij viti, mirëpo janë tri çështje të cilat dua t'i potencojojë, si informim më i detajuar. Zyra për komunitete dhe kthim, ka dorëzuar listën e 192 familjeve, me gjendje të rëndë ekonomike, në Drejtorin e Mirëqenies Sociale, për planifikimin paraprak buxhetor, për t'i ndihmuar me dru zjarri për ngrohje, gjatë sezonit të dimrit. Pas dorëzimit të listës, jemi takuar me drejtorin dhe ishin shumë të kënaqur se lista iu ka dërguar në këtë kohë dhe jo si zakonisht në kohë vjeshte. Sipas tyre, do të rishikohet buxheti, që ti ndajnë në të gjitha familjet. Besoj që nga shtatori do t'u kërkohen dokumente shtesë të familjeve. Në vazhdimësi do të ju informojmë për procedurat e tjera.

Kishte me qenë mirë me e potencua edhe konkursin e rekrutimit të kadetëve të rinj. Ju km njoftuar edhe me email, por dua të ju njoftojë edhe këtu, dhe besojë se i keni njoftuar anëtarët e komunitetit tuaj. Thirrja tjetër është programi i organizatës IOM, e cila parashev shumë mbështetje, për organizatat joqeveritare, që punojnë në kuadër të komuniteteve dhe për individ. Nëse dikush shpreh interesim me aplikuar, mundemi me i ndihmuar duke e ftuar përfaqësuesin e organizatës IOM, teknikisht me ju ndihmua rreth procedurës së aplikimit, sigurish duke ndërmjetësuar përmes zyrës sonë.

Njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-së për muajin maj 2024.

Pika e tetë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Pika e nëntë

Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

**Procesmbajtësja
Lendita Spahija**

**Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli**



Faqe 8 nga 8